

NDËRLIDHJA NË MES TË FAKTORËVE DEMOGRAFIKË ME
NIVELIN E KONSUMIMIT NË PUNË TEK PROFESIONISTËT E
EDUKIMIT SPECIAL

TEMA PËR TITULLIN MASTER I ARTEVE
NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

NGA

BRIKENDA METAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIMI
PRISHTINË

SHKURT, 2023

Ndërlidhja në mes të faktorëve demografik me nivelin e konsumimit në punë tek profesionistët e edukimit special

Kandidatja: **Brikenda Metaj**

Mentori: **Prof. Ass. Dr. Mytaher Haskuka**

Ky hulumtim synon të identifikojë nivelin e përjetimit të konsumimit tek profesionistët e edukimit special dhe ndërlidhjen e faktorëve demografik me procesin e konsumimit. Rëndësia e këtij studimi lidhet me rendësin e rritjes së vëmendjes ndaj fushës së edukimit special, ndaj profesionistëve të kësaj fushe, nevojës për të hulumtuar faktorët ndikues dhe nevoja për të zhvilluar në të ardhmen strategji përballuese të cilat lehtësojnë punën e tyre dhe zvogëlojnë mundësinë e përjetimit të konsumimit.

Punimi është i ndarë në katër kapituj:

Kapitulli I: Hyrje

Në pjesën hyrëse të punimit është diskutuar rëndësia e këtij hulumtimi, duke pasur parasysh mungesën e hulumtimeve për konsumimin në kontekstin Kosovar, këtu spjegohet se si manifestohet konsumimi me tre komponentët e tij (lodhjen emocionale, depersonalizimin dhe arritjen personale) tek profesionistët e edukimit special, sfidat që ata hasin në punë dhe rëndësia e identifikimit të faktorët që ndikojnë në shfaqjen e konsumimit, me theks të veçantë në faktorët demografik siq janë moshë, gjinia, statusi civil, lloji i çrregullimit që ka nxënësi dhe përvoja e punës. Më pas shtjellohet ndikimi i konsumimit tek nxënësit që marrin shërbimet e tyre.

Kapitulli II: Shqyrtimi i literaturës-prespektiva teorike

Bazuar nga këndvështrimet teorike, teoria mbi burimet ofron një konceptualizim më të qartë mbi shtjerrimin e burimeve që qon në konsumim, si dhe teori të tjera janë teoria shkëmbimit social, teoria e paanësisë dhe reciprocitetit. Pjesa tjetër e literaturës nga ky kapitull i referohet arsyetimit dhe rëndësisë së studimit të këtyre ndërlidhjeve. Gjithashtu, ofrohen hulumtime të ndryshme të

cilat janë realizuar në vende të ndryshme të botës dhe që shtjellojnë ndërveprimin në mes të faktorëve demografik dhe përjetimit të konsumimit, literaturë kjo pas së cilës ka pasuar ngritja e pyetjeve kërkimore dhe hipotezave: Studimi do të përpiqet që t'u përgjigjet pyetjeve kërkimore të cilat janë:

1. Sa është i shfaqur konsumimi në punë tek profesionistët e edukimit special në Kosovë?
2. Si shfaqen perceptimet e profesionistëve të edukimit special në lidhje me elementet e konsumimit?
3. Çfare ndërlidhje ekziston në mes të nivelit të konsumimit dhe faktorëve demografik tek profesionistët e edukimit special?

Hipotezat:

H1: Ekziston ndërlidhje positive në mes të nivelit të konsumimit dhe moshës tek profesionistët e edukimit special.

H2: Do të ketë dallime gjinore në përjetimin e niveleve të konsumimit tek profesionistët e edukimit special.

H3: Do të ketë dallime në nivelin e konsumit tek profesionistët e edukimit special në bazë të përvojës së punës.

H4: Do të ketë dallime në nivelin e konsumimit tek profesionistët e edukimit special në bazë të statusit civil.

H5: Do të ketë dallime në nivelin e konsumimit tek profesionistët e edukimit special në bazë të llojit të çrregullimit që kanë fëmijët.

Kapitulli III: Metodologjia

Në këtë kapitull, përshkruhen atributet e pjesëmarrësve të këtij studimi, mënyra e kampionimit, instrumentet matëse të përdorura, dimensionin kohor, procedura e mbledhjes së të dhënave, konsiderata etike në lidhje me hulumtimet, pyetësin dhe pjesëmarrësit. Hulumtimi është

realizuar me 137 pjesmarrës që përfshinte psikolog, terapist, asistentë të fëmijëve me aftësi të kufizuara, logoped, ergoterapist, edukator, mësime dhënëse lëndor, mësime dhënëse udhëuese që punojnë në shkolla publike/private, në qendra të edukimit special. Për mbledhjen e të dhënave është përdorur pyetësi i përgjithshëm i pyetjeve demografike (mosha, gjinia, statusi civil, pervoja e punës, vendbanimi, niveli i edukimit, profesioni, numri i fëmijëve, çrregullimi që ka nxënësi dhe orari i punës ne ditë), dhe instrumenti për matjen e konsumimit inventari i Konsumimit i Maslach. Dizajni i këtij hulumtimi është sasior, ndërsa në aspektin kohor është ndër-seksional.

Kapitulli IV: Rezultate, Diskutimi, Limitime, Rekomandime, referenca dhe Shtojcë

Te pjesa e rezultateve, përshkruhen rezultatete në mënyrë të përmbledhur, diskutohen të gjeturat në mbështetje të literaturës, po ashtu këtu prezantohen edhe limitet e studimit si dhe rekomandimet për studime tjera në këtë fushë. Nga rezultatet e gjetura, përmes analizave përshkuese rezultuan që profesionistët e edukimit special përjetojnë konsumim nën nivelin mesatar. Në lidhje me komponentet e konsumimit u gjet se profesionistët e edukimit special përjetojnë nivele të ulëta të lodhjes emocionale dhe depersonalizimit ndërsa nivel të lartë të arritjes personale. Me anë të testit të Anovës rezultoi se ka një ndërlidhje pozitive në mes të përvojës dhe konsumimit ku dallimi më domethënës midis grupeve të përvojës në punë është tek ata që kishin 1-5 vite punë me ata që kishin mbi 20 vite punë, po ashtu u gjetë se ekziston një dallim i rëndësishëm dhe domethënës në mes të llojit të çrregullimit dhe konsumimit, ky dallim është gjetur tek çrregullimi paaftesi intelektuale me çrregullimin e komunikimit, dhe në mes të paaftesi intelektuale dhe çrregullimit të spektrit të autizmit. Sa u përket faktorëve tjerë demografik mosha, gjinia, statusi civil nuk u gjetë se kanë ndërlidhje domethënëse me konsumimin. Në këtë kapitull përshkruhet edhe diskutimi i cili është mbështetur nga disa perspektiva teorike dhe nga rezultatet apo gjetjet nga hulumtime të tjera të ngjashme të cilat i mbështesin hipotezat e parashtruara në studimin hulumtues. Te pjesa e rekomandimeve kerkohet

të ketë rritje të vëmendjës për kryerjen e studimeve të ngjajshme më të detajuara në fushën e edukimit special. Po ashtu rekomandohet hartimi i politikave sociale në mbështetje të profesionistëve që punojnë në institucione arsimore të edukimit special dhe më gjerë si dhe planeve konkrete në mbështetje të fushës së edukimit special në Kosovë.